



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

WWW.INVESTMENT.COM.AL



OPTIMIZIMI || INVESTIMEVE NË AGRO-PËRPUNIM

JANAR 2021

*Ky publikim synon të sjellë sektorin e agro-përpunimit në vëmendjen e vendimmarrësve apo investitorëve me synim rritjen e fokusit në produktet vendase dhe markën “Made in Albania”. Informacioni i ofruar mund të shërbejë si një shembull (që mund të vlerësohet më tej) për optimizimin e potencialeve të investimeve. Ky dokument mund të lexohet së bashku me **Notën Teknike “Prodhimi i Brendshëm, Zëvendësimi i Importeve dhe Nxitja e Investimeve në Agro-përpunim”** (tetor 2020), e cila përpiqet të japë një panoramë më të gjerë mbi sektorin.*

- përgatitur në kontekstin e Mbledhjes XXII të Këshillit të investimeve - nëntor 2020.

PËRMBAJTJA

- 03 Lista e Incentivave për Bujqësinë dhe Agro-përpunimin
- 06 Investime Strategjike në Përpunimin e Domates
- 07 Karta Teknologjike – Domate për Salcë në Fushë në Sipërfaqen 1ha

Incentivat kryesore të drejtpërdrejta dhe masat mbështetëse në lidhje me sektorët e bujqësisë/agropërpunimit

01 TVSH-ja e përjashtuar për inputet bujqësore dhe makineritë.

Kjo pjesë stimuluese e paketës fiskale 2019 u zbatua përmes ndryshimit të ligjit 92/2015 “Për TVSH-në”¹, me kusht që furnizimi i makinerive bujqësore dhe furnizimi i inpueteve bujqësore të tilla si plehra kimikë, pesticide, fara dhe fidanë, përveç hormoneve, të listuara dhe të përcaktuara përmes vendimeve të KM përjashtohen nga TVSH-ja.

02 Prezantimi i incentivës së lartpërmendur me paketën fiskale të vitit 2019 u pasua nga ulja e normës së TVSH-së për fermerët e regjistruar me TVSH nga 20% në 6%. Një ulje e tillë krijoi shumë ankesa dhe diskutime kryesisht nga mbledhësit të cilët dukshëm përfituan më shumë nga zbatimi i 20% të normës së kompensimit të TVSH-së.

Vlen të përmendet se në vitin 2014, Qeveria prezantoi përmes një udhëzimi specifik² njohjen e TVSH-së për qëllime kompensimi të produkteve bujqësore me 20% krahasuar me 6% të mëparshme për prodhuesit dhe mbledhësit e bujqësisë, duke përcaktuar në detaje mënyrën e funksionimit

¹ Ndryshuar me Ligjin nr. 96/2018 datë 03.12.2018

² Udhëzimi i MFE Nr. 19 datë 03.11.2014 “Për Zbatimin e Regjimit të Posaçëm për Skemën e Kompensimit të Prodhuesve Bujqësorë për Qëllimet e Taksës së Vlerave të Shtuara

të skemën përkatëse dhe duke krijuar uniformitet në zbatimin e TVSH-së. Udhëzimi i ri deri në atë kohë u konsiderua nga qeveria, fermerët dhe mbledhësit, si një mundësi për të krijuar tregje të reja, formale dhe të sigurta për fermerët duke u siguruar atyre NIPT dhe një kompensim prej 20%. Skemat e mëparshme kishin për qëllim sigurimin e mbështetjes për fermerët duke siguruar vetëm 6% të rimbursimit, por nga ana tjetër që pësuan kosto shtesë për mbledhësit, për të cilët ishte e pamundur të ngarkohej (përveç klientit përfundimtar) me ndryshimin prej 14 % ndërmjet TVSH-së në blerjen dhe shitjen e produktit. Ky stimul dhe pritjet e tij ishin objekt i analizës nga Sekretariati dhe diskutimeve në mbledhjen Nr. 6 të Këshillit të Investimeve.

Sipas grumbulluesve, skema nuk është më tërheqëse pas ndryshimit të vitit 2019, ndërsa sipas qeverisë, përfitimet e masës së 2014 nuk u transferuan fermerëve si të tillë, por ishin kryesisht mbledhësit që përfituan nga 20% normë e kompensuar e TVSH-së.

03 Duke filluar nga 2021, Qeveria Shqiptare ka njoftuar se do të heqë akcizën, karbonin dhe taksën rrugore nga çmimi përfundimtar i karburantit që u nevojitet fermerëve për të kultivuar tokën e fermës. Një masë e tillë mendohet të nxisë formalizimin e fermerëve të regjistruar në NUIS, do të ulë kostot e produkteve primare të cilat potencialisht do të ishin më konkurruese në rajon. Skema e mbështetjes do të prezantohet përmes rrugëve elektronike e cila potencialisht do të shmangte çdo mashtrim me skemën. Kriteret, procedurat, dhe mënyra e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë janë të detajuara këtu.



04 Skemat kombëtare dhe IPARD të AZHBR me grante përmbajnë disa masa:

a) Skemat Kombëtare të Mbështetjes:

Masa 1: Tufa e bazës së maturuar

Masa 2: Bletaria

Masa 3: Financimi për zëvendësimin e plastikës termike

Masa 4: Mbjellja e bimëve mjekësore dhe aromatike

Masa 5: Mbështetja për fermat organike dhe certifikimin Global Gap

Masa 6: Investimet në agroturizëm

Për më shumë informacion, kliko këtu.

b) Programi IPARD:

Programi IPARD është mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga fondet e BE-së (75%) dhe qeveria shqiptare (25%).

Masa 1: Investime në asetet fizike të fermave bujqësore

Masa 3: Investime në asetet fizike në lidhje me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, blegtorale dhe të peshkimit

Masa 7: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit

Për më shumë informacion, kliko këtu.

Kjo përmbledhje përmban informacion të përgjithshëm nga ligje, akte nënligjore ose pjesë të tjera të domeinit publik. Informacioni që jepet në këtë dokument nuk është shterues dhe nuk zëvendëson asistencën profesionale ose këshillimin që mund t'i nevojitet institucionit tuaj. Asnjë pjesë e këtij dokumenti, nuk mund të përdoret për ndonjë qëllim tjetër nga ai i specifikuar.

INVESTIME STRATEGJIKE NË AGROBIZNES

Sektori:	Përpunimi i domates	
Investimi në Teknologji:	Prodhimi i salcës së domates	
Teknologjia:	Linjë përpunimi salcë (pure aseptike)	
Numri i fabrikave të nevojshme:	1 fabrike me kapacitet 5-7 ton/ora	
Vlera financimit për linjë	1.2 milion Euro	
Kërkesa e Tregut për Shqipërinë:	2000 ton salcë domate	
Prodhimi i salcës	Lëndë e parë	Prodhimi i salcës
	Domate (varietetet Roma, Giuleta, San Marziano etj.)	100 %
Nevoja për salcë domate në Shqipëri	Skeda Teknologjike	Nevoja për salcë domate në Shqipëri
	2000 ton salcë domate	1 ton domate = 600 kg salcë
Standarti i kërkuar i cilësisë dhe sigurisë	<input type="checkbox"/> Global G.A.P. <input type="checkbox"/> IFS <input checked="" type="checkbox"/> HACCP <input type="checkbox"/> Organik <input checked="" type="checkbox"/> Standard tjetër: ISO 22000	
Tregu kryesor i shitjeve:		
- Rajonal (AL, BH, KS, MK, SRB)	x Treg lokal dhe rajonal	
- Ndërkombëtar	X Kërkesë nga furnizues ndërkombëtar	
Komente shpjeguese	<p>Kërkesa e tregut shqiptar për salcë domate është e lartë, por problematika qëndron në sigurimin e lëndës së parë. Afërsisht kërkohet të kultivohen rreth 70-80 ha domate për salcë për të siguruar konsumin vendas. Ndërkohë që kërkesa për eksport është 3 herë më e lartë se konsumi kombëtar, pra kërkohet rreth 200-250 ha kultivim domate për salcë. Bazuar në Kartën Teknologjike, kosto për prodhimin e 1 ha domate për salcë është rreth 8000 euro/ha. Pra, kërkohet një investim prej 560,000 euro për sigurimin e lëndës së parë për të siguruar kërkesën e tregut vendas, dhe 1.6 mil euro për të siguruar edhe tregun e eksportit.</p>	

KARTA TEKNOLOGJIKE- DOMATE PËR SALCË NË FUSHË NË SIPËRFAQEN 1HA

Rendiment 800 kv/ha domate për
salcë në fushë. Skema mbjelljes 60
x 40 cm (24 mijë bimë/ha)

A. Shpenzime për Punë me krah lekë

Nr.	Proçeset e punës	Dite/njeri	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Pergatitje toke+Plehim baze	6		6										
2	Mbjellja	30			30									
3	Sherbime kulturale	50				10	10	10	10	10				
4	Vjelje dhe pergatitje prodhimi per treg	100							40	60				
5	Te paparashikuara	50				10	10	10	10	10				
6	Shuma Dite/njeri	236		6	30	20	20	20	60	80				
7	Pagesa per Dite/njeri + sSg shoq. lekë	1500		1500	1500	1500	1500	1500	1500	1500				
SHUMA (A). Shpenzime për punë me krah (lekë)		354,000		9,000	45,000	30,000	30,000	30,000	90,000	120,000				

B. Shpenzime për mjete motorrike

Nr.	Proçeset e punës	Njësia	Volumi	Vlera për njësi	Total	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Plugim 35-40cm i thellë	dyn	10	1,200.00	12,000.00			12,000									
2	Transport dhe shpërndarje pleh organik ne parcelë	ton	50	100	5,000.00		5,000										
3	Frezim	dyn	10	800.00	8,000.00			8,000									
4	Sperkatje	nr.	10	5200	52,000.00				5,200	10,400	15,600	15,600	5,200				
5	Transport prodhimi nga parcela në magazinë	ton	100	1500	150,000.00							60,000	90,000				
6	Të paparashikuara				4,000.00					1,000	1,000	1,000	1,000				
SHUMA (B)					231,000		5,000	20,000	5,200	11,400	16,600	76,600	96,200				

C. Shpenzime për Materiale

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vlefte për njësi lekë	Vlefte gjithsej	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Fidanë (+ 10 % rezervë për moszënjet)	fidanë	26000	12	312,000				312,000								
2	Pleh organik	kv	100	200	20,000			20,000									
3	Plehim baze NPK	kg	400	70	28,000				28,000								
4	Fosfor	kg	300	60	18,000					9,000		9,000					
5	NPK per rritje dhe pjekje	kg	250	50	12,500						2,500	5,000	5,000				
11	Ujë për ujitje	m ³	4000	5	20,000				2,000	3,000	5,000	6,000	4,000				
12	Të paparashikuara				8,000					2,000	2,000	2,000	2,000				
SHUMA (C)					418500			20,000	342,000	14,000	9,500	22,000	11,000				
TOTAL (shuma A + B + C)					1,003,500		14,000	85,000	377,200	55,400	56,100	188,600	227,200				

D. Shpenzime për tjera

Nr.	Emërtimi	Vlefte gjithsej	J	SH	M	P	M	Q	K	G	SH	T	N	DH
1	Asistence agroteknike	25000				5000	5000	5000	5000	5000				
2	Takse toke (vjetore)	8,000		8,000										
SHUMA (D)		33,000		8,000		5,000	5,000	5,000	5,000	5,000				
TOTAL (shuma A + B + C + D)		1,036,500		22,000	85,000	382,200	60,400	61,100	193,600	232,200				

13

Kosto e prodhimit (Lek/kg)

20

Çmimi i shitjes (Lek/kg)

1.6 milionë

Të ardhurat nga shitja

1.6 milionë

Të ardhurat në TOTAL (lekë)

563.5 mijë

FITIMI (lekë)



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomike
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

Facebook Albania Investment Council Twitter ALInvestCouncil LinkedIn Albania Investment Council



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).